



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL

Nr: 1877 Prot.

Berat më, 26.03.2026

NJOFTIM

**“PËR ORGANIZIMIN E DËGJESËS PUBLIKE NË LIDHJE ME MIRATIMIN E
PLANIT TË VEPRIMIT TË BARAZISË GJINORE 2026-2028”**

Ligji nr.13/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” përcaktuan qartësisht detyrimin e Bashkisë për të identifikuar nevojat për shërbimet e kujdesit shoqëror, për t’i planifikuar dhe ngritur këto shërbime. Aktualisht bashkia Berat është në proces hartimi të Planit të Veprimit të Barazisë Gjinore ku përgatitja e një plani të tillë është domosdoshmëri për Bashkinë tonë, pasi ky është një detyrim për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore bazuar në Strategjinë Kombëtare të Veprimit për Barazinë Gjinore 2021-2030 (objektivi specifik IV.3, aktiviteti IV.3.1.d.).

Në vijim të procesit të konsultimit me publikun ju ftojmë të merrni pjesë në dëgjesën publike, ditën e enjte datë 09/04/2026 ora 10:00 pranë ambienteve të bashkisë Berat, sala e konferencave.

Gjatë takimit të dëgjesës publike do të bëhet prezantimi i Planit të Veprimit të Barazisë Gjinore 2026-2028.

